



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 01/20
Datë: 31.03.2020

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 4 paragrafi 2.1 të Rregullores Nr. 05/2020 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, dhe nenet 17 dhe 19 të Rregullores Nr. 09/2011 të Punës së Qeverisë, duke marrë parasysh Vendimin e Qeverisë nr. 01/14 të 20 marsit 2020, Qeveria në detyrë e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 31 mars 2020, nxjerr këtë:

V E N D I M

Për zbatimin gradual të reciprocitetit si parim në marrëdhëniet me Serbinë

1. Në marrëdhëniet tregtare me Serbinë, emërtimet e përdorura në dokumentet si në vijim të jenë në përputhje me Kushtetutën e Republikës së Kosovës dhe legjislacionin në fuqi:
 - 1.1. Certifikata fitosanitare dhe dokumentacioni shoqërues për produktet ushqimore dhe joushqimore me prejardhje bimore dhe joshtazore që i nënshtrohen kontrollit fitosanitar në kufi;
 - 1.2. Certifikata veterinare dhe dokumentacioni shoqërues për produktet ushqimore dhe joushqimore me prejardhje shtazore që i nënshtrohen kontrollit veterinar në kufi;
2. Detyrohen të zbatojnë këtë vendim:
 - 2.1. Policia kufitare;
 - 2.2. Dogana;
 - 2.3. Agjencia e Ushqimit dhe Veterinarisë;
 - 2.4. Agjencia për Produkte dhe Pajisje Medicinale; dhe
 - 2.5. Institucionet e tjera përgjegjëse.
3. Zbatimi dhe përshtatshmëria e këtij vendimi do të rishikohen së paku një herë në muaj.
4. Shfuqizohen vendimet e Qeverisë nr. 01/76 i 21 nëntorit 2018 dhe nr. 06/82 i 28 dhjetorit 2018.
5. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit dhe mbetet në fuqi deri më 15 qershor 2020.

ARSYETIM

Masat e reciprocitetit ose veprimit të ndërsjellë janë institut i marrëdhënieve mes shteteve sovraane i njohur nga parimet e përgjithshme të së drejtës ndërkombëtare.

Marrëveshja e Përgjithshme për Tarifat dhe Tregti (GATT) e vitit 1947, e ndryshuar më 1994, është instrument themelues i Organizatës Botërore të Tregtisë. GATT njih parimet themelore të reciprocitetit, mosdiskriminimit dhe shtetit më të favorizuar. Në thelb, këto parime shërbejnë për të dhënë një rezultat efikas dhe trajtim të barabartë të politikës tregtare, duke eliminuar barrierat në tregti.

Marrëveshja e Tregtisë së Lirë e Evropës Qendrore (CEFTA) e vitit 2007, ndër të tjera, ka për qëllim kryesor të eliminojë barrierat tregtare dhe të lehtësojë lëvizjen e mallrave në transit dhe lëvizjen ndërkufitare të mallrave dhe shërbimeve midis territoreve të vendeve.

Traktati i Komunitetit të Transportit, i nënshkruar nga Bashkimi Evropian, Serbia dhe Republika e Kosovës, krahas vendeve të tjera të Ballkanit Perëndimor, gjithashtu parasheh që palët të zbatojnë legjislacionin e BE-së për transportin rrugor.


Politika Tregtare e Kosovës, miratuar nga Qeveria më 2009, synon që përfitimet nga liberalizimi i tregtisë të jenë më të larta dhe më të qëndrueshme.

Që nga hyrja në fuqi e CEFTA-s, Serbia ka vendosur një sërë barrierash tregtare jotarifore ndaj Republikës së Kosovës, duke përfshirë barrierat në transit, barrierat teknike dhe barrierat politike. Kështu Serbia ka dëmtuar eksportuesit dhe importuesit nga Republika e Kosovës dhe kanë shkaktuar një deficit të lartë tregtar për Republikën e Kosovës.

Barrierat jotarifore janë të paraqitura në detaje në dokumentin "Propozim për masa të reciprocitetit për të rregulluar tregtinë me Serbinë dhe Bosnjë-Hercegovinën", të datës 20 shkurt 2020, i parashtruar nga Grupi Punues për Barrierat Tregtare, i themeluar Ministria e Ekonomisë, Punësimit, Tregtisë, Industrisë, Ndërmarrësisë, Investimeve Strategjike (bashkëngjitur si shtojcë).

Rrjedhimisht, duke u mbështetur në parimet dhe arsyet e sipërcekura, Qeveria vendosi si në dispozitiv.

Albin KURTI



Kryeministër në detyrë i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- Të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-së
- Sekretariatit të CEFTA-s
- Arkivit të Qeverisë